



**QYTETARI NË  
REND TË PARË**

# KU SHKOJNË PARATË E MIA?



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian  
dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike Shkup



**ALKA**



## Çfarë punon komuna?

**K**omunat janë përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve në fushat e mëposhtme: planifikimi urban (urban dhe rural), dhënie e lejeve të ndërtimit për ndërtesat me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi hapësinor dhe rregullimi i tokës ndërtimore; mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës; zhvillimi ekonomik lokal; shërbimet komunale; kultura; sporti dhe rekreacioni; kujdesi social dhe mbrojtja e fëmijëve; arsimit fillor dhe i mesëm; kujdesi shëndetësor; mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve dhe mallrave; mbrojtja nga zjarri; dhe çështje të tjera të përcaktuara me ligj.



2

## Buxheti komunal

Sipas Ligjit për buxhete, buxheti i njësisë së vetëqeverisjes lokale paraqet një plan vjetor i të ardhurave, hyrje tjera dhe mjete të miratuara dhe e përfshin buxhetin bazë, buxhetin e dotacioneve, buxhetin e donacioneve, buxhetin e huamarrjeve dhe buxheti i aktiviteteve vetë-financuese.

Gjatë hartimit të buxheteve për realizimin e prioriteteve në nivel lokal, komuna udhëhiqet nga prioritetet strategjike të Qeverisë, strategjia fiskale, propozimi i planeve strategjike të përdoruesve të buxhetit dhe politikave buxhetore.

Buxheti komunal përbëhet nga pjesa e përgjithshme, ajo e posaçme dhe pjesa zhvillimore.

### Pjesa e përgjithshme përfshin:

- ◆ Bilanci i konsoliduar i të ardhurave dhe shpenzimeve;
- ◆ Klasifikimi funksional i shpenzimeve;
- ◆ Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve kapitale.




Në pjesën e veçantë të buxhetit janë treguar shpenzimet sipas klasifikimit të shpenzimeve të përcaktuara nga Ministri i Financave, të grupuara sipas përdoruesve dhe programeve. Pjesa e veçantë përmban shpjegim për buxhetin.

Të ardhurat janë hyrjet në buxhetin komunal të përbëra nga të ardhura tatimore, jostatimore dhe të hyrat kapitale, të ardhurat nga dotacionet, transferimet dhe të ardhurat nga donacionet, subvencionet si dhe lloje të ndryshme të kontributeve për shërbime të kryera. Për qindja më e madhe i hyrjeve në buxhetin komunal janë nga tatimet (më të rëndësishmet janë tatimi në pronë dhe tatimi mbi të ardhurat), taksat e ndryshme dhe kontributet.

Shpenzimet paraqesin shpenzimin e fondeve buxhetore për qëllime/aktivitete të ndryshme. Ato janë shpenzime të bëra për financimin e ofertës së të mirave publike të arritura përmes realizimit të të ardhurave publike për qëllime të interesit publik.

## Si miratohet buxheti?

- ♦ Ministri i Financave jo më vonë se më 30 shtator të vitit rrjedhës, do të përgatisë një qarkore buxhetore për vitin e ardhshëm.
- ♦ Me qarkoren buxhetore komunat njoftohen mbi treguesit bazë makroekonomik, drejtimet kryesore për përgatitjen e buxhetit komunal, dotacionet për komunën që do të transferohen nga Buxheti i vendit, buxhetet e fondeve, si dhe nga të ardhurat e burimeve tjera.
- ♦ Kryetari i komunës përgatit Propozim-plan të programeve për zhvillim, në përputhje me udhëzimet e Qarkores së Ministrisë së Financave dhe të njëjtën e dorëzon për miratim në Këshillin komunal, më së voni deri më 20 tetor të vitit rrjedhës. Këshilli komunal e miraton Propozimin e planit të programeve zhvillimore deri më 15 nëntor të vitit rrjedhës. Plani i miratuar i programeve të zhvillimit është pjesë integrale e propozim-buxhetit komunal.
- ♦ Këshilli komunal miraton buxhetin për vitin e ardhshëm më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës, sipas llogarive, nën-programeve dhe paragrafëve.



## Miratimi i llogarisë vjetore

Pas përfundimit të vitit fiskal, Këshilli komunal miraton Llogari vjetore të buxhetit komunal. Ai përmban të gjitha elementet e përfshira në buxhetin komunal, të shprehura si të ardhura planifikuara dhe të realizuara për të gjithë përdoruesit e buxhetit komunal. Kryetari i komunës e dorëzon llogarinë vjetore për miratim te Këshilli komunal, jo më vonë se data 28 shkurt i vitit të ardhshëm. Këshilli miraton llogarinë vjetore deri më 15 mars të vitit rrjedhës, për vitin paraprak, dhe e dërgon në Ministrinë e Financave, jo më vonë se 31 mars të vitit rrjedhës. Pas miratimit të llogarisë vjetore Kryetari për përmbajtjen e tij e informon publikun.


## Pasqyrat periodike financiare

Përdoruesit komunal buxhetor brenda 15 ditëve pas përfundimit të muajit për të cilin bëhet fjalë, dorëzojnë te Kryetari raportet mujore me një shpjegim për kryerjen e planeve të tyre financiare.

Kryetari i komunës dorëzon në Ministrinë e Financave dhe te Këshilli Komunal raportet tremujore me sqarim të ekzekutimit të buxhetit brenda një muaji pas përfundimit të tremujorit. Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen në raportin.

4

## Çfarë është buxhetimi me pjesëmarrje?



Buxhetimi me pjesëmarrje është një proces i vendimmarrjes në komunitet, nëpërmjet të cilit qytetarët drejtpërdrejt japin propozime dhe negociojnë për shpërndarjen e fondeve publike. Procesi i miratimit të buxhetit duhet të jetë i hapur për të gjithë anëtarët e interesuar të komunitetit lokal, pa kufizim të grupeve (ekskluzive) të caktuara, shoqata apo individë.

Qëllimi i buxhetimit me pjesëmarrje është rritja e përgjegjësisë sociale, rritja e fuqisë dhe zërit të qytetarëve si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës përmes plotësimit të nevojave të komunitetit lokal. Gjithashtu, me anë të buxhetimit me pjesëmarrje i mundësohet administratës të zhvillojë qeverisje lokale pjesëmarrëse dhe përgjegjëse të cilës do ti besohet dhe njëkohësisht ju mundësohet qytetarëve ta përmirësojnë jetën e tyre, me idetë dhe pjesëmarrjen e tyre.

## Buxheti për ekspertë ose buxheti civil?

Qasja e vendosur për planifikimin dhe raportimin buxhetor pas realizimit të buxhetit është rigjid në kontekstin e tregimit të financave të planifikuara dhe të realizuara. I paraqitur në këtë mënyrë buxheti i pushtetit lokal mund të jetë i pakuptueshëm për qytetarin mesatar i cili nuk ka njohuri të termave të kontabilitetit dhe atyre ekonomik.

**Prandaj insistonet të futet Buxheti Civil i cili para së gjithash duhet sipas terminologjisë, mënyrës së përgatitjes dhe prezantimit të jetë më i qartë dhe më i kuptueshëm për qytetarët dhe në fund të fundit do tu lehtësonte qytetarëve të marrin pjesë në përgatitjen e tij.**

## Çfarë është buxheti civil?

Buxheti Civil synon prezantimin më të lehtë të paragrafëve të buxhetit në mënyrë që qytetarët më lehtë të kuptojnë se si financohet komuna dhe për cilin qëllim shpenzohen fondet e buxhetit.

Kjo do të mundësojë menaxhim më transparent financiar të vetëqeverisjeve lokale, sepse qytetarët kanë një pasqyrë shumë më të mirë se si menaxhohet me paratë e tyre. Si pasojë e kësaj, pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e vendimeve më të rëndësishme lokale, duke përfshirë procesin e miratimit të buxhetit komunal.



## Buxheti dhe të dhënat e hapura

Të dhënat e hapura qeveritare janë të gjitha të dhënat që i posedon sektori publik, të publikuara në internet në format të përpunueshëm kompjuterik, të arritshme për të gjithë qytetarët dhe të lira për ti përdorur dhe përpunuar.

Publikimi i të dhënave financiare në format të hapur do të lejojë përdorimin më të lehtë të këtyre të dhënave nga ana e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në kryerjen e hulumtimit dhe analizave. Gjegjësisht, publikimi i të dhënave financiare në formë të papërpunuar dhe në format elektronik që është i përshtatshëm për përpunim automatik, ofron një mundësi për kryqëzimin e të dhënave nga burime të tjera, dhe me këtë marrje më cilësore dhe më relative të rezultateve.

Me lirimin e të dhënave të hapura financiare, sidomos ata që favorizojnë dokumente kryesore fiskale të tilla si buxheti, llogaritë vjetore dhe raportet financiare tremujore dhe vjetore, dhe sidomos në qoftë se janë të strukturuar me programe, mund të zhvillohen aplikacione për vizualizim të buxhetit të planifikuar dhe zbatimin e buxhetit.




Figura 1 - Aplikacion “Ku shkojnë paratë e mia”

Një shembull i tillë është aplikacioni “Where does my money go” (Ku shkojnë paratë e mia) nga Britania e Madhe. Aplikacioni tregon se si buxheti është i shpërndarë në Mbretërinë e Bashkuar në fusha, gjegjësisht sa nga buxheti ndahet për shëndetësi, arsim, mbrojtje, kulturë etj. Përdoruesi mund të bëjë analizë më të detajuar se si shpenzohen fondet brenda një fushe. Këto informacione janë të segmentuara edhe në rajone që të mundën qytetarët të bëjnë një krahasim si zbatohet buxheti në pjesë të ndryshme të Britanisë së Madhe.

Në varësi të parametrave të dhëna për të ardhurat e tyre, qytetarët mund të marrin vizualizimin për atë si ndahen tatimet për të ardhurat e tyre, apo sa ju takon në fusha të ndryshme në politikat publike.

Gama e madhe e të dhënave të publikuara financiare përdoren në aplikacionin për të shfaqur informacione në detaje për të gjitha shpenzimet nga ana e autoriteteve në Britani të Madhe, të cilat tejkalojnë 25.000 sterlina.



**QENDRA PËR  
MENAXHIM ME  
NDRYSHIME**

#### **Qendra e menaxhimit me ndryshime**

Rr. Rajko Zhinzifov nr. 44-1, Shkup  
Tel.+389(0)2 6092-216  
e-mail: info@cup.org.mk  
ueb: www.cup.org.mk

# ALKA

#### **Qendra për zhvillim të qëndrueshëm - ALKA**

Bul. Partizanski odredi nr. 62-1/16, Shkup  
Tel.: + 389(0)2 3214-505  
e-mail: alka@alka.org.mk  
ueb: www.alka.mk



Bashkimi Evropian

Ky publikim është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Qendrës për menaxhim me ndryshime dhe Qendra për zhvillim të qëndrueshëm - ALKA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.



British Embassy  
Skopje

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Ambasada Britanike Shkup në kuadër të projektit - Qytetari në rend të parë. Pikëpamjet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë gjithmonë pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Projekti - Qytetari në rend të parë - është zbatuar nga Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve në partneritet me Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm - Alka. Bashkëpunëtorë në këtë projekt janë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Projekti është i financuar nga Delegacioni Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhjen e kontraktave (CFCD) dhe i bashkë-financuar nga Ambasada Britanike.

Projekti fokusohet në përmirësimin e transparencës së njërive të vetëqeverisjeve lokale duke vendosur standarde për të dhëna të hapura në nivel lokal me qëllim të përfshirjes më të mirë të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e punës dhe vendimmarrjes nga ana e komunave.